



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Mbledhja konstitutive e Kuvendit të Kosovës

P- 001

Prishtinë, më 21 shkurt 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKES SE KOSOVES, TE
MBAJTUR ME 21 SHKURT 2011**

Mbledhjen konstitutive e kryesoi deputetja më e vjetër në moshë, Flora BROVINA, kurse i ndihmoi deputetja më e re, Biserka Kostiq.

Kryesuesja konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm 117 deputetë dhe i hapi punimet e mbledhjes konstituive.

Ajo, në fillim përshëndeti përfaqësuesin e ZNC, z. Piter Feith; komandantin e KFOR-it, gjeneralin Erhard Bühler; ambasadorin e SHBA-ve, z. Kristofer Dell, përfaqësuesit e misionëve dhe të zyrave diplomatike, të akredituar në Prishtinë; Përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë, si dhe të gjithë të tjerët të pranishëm në mbledhje konstituive.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Formimi i Komisionit të përkohshëm për verifikim e kuorumit dhe të mandateve,
2. Dhënia e betimit të deputetëve,
3. Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit,
4. Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit.

1. Formimi i Komisionit të përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve

Kryesuesja i ftoi partitë parlamentare që, në bazë të nenit 9.4 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, ta propozojnë nga një deputet në Komisionin për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve, i cili do ta shqyrtojë dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010 dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin lidhur me to.

Partitë parlamentare i propozuan anëtarët e Komisionit për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve, si vijon:

Xhavit Haliti, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, propozoi deputetin Idriz Vehapi,
Ismet Beqiri, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoi deputetin Armend Zemaj,
Visar Ymeri, në emër të Lëvizjes “VETVENDOSJE” propozoi deputeten Alma Lama,
Ardian Gjini, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, propozoi deputeten Teuta Haxhiu,
Ibrahim Makolli, në emër të Koalicionit AKR-PD-PSD-PPI-PPKPNDH-PGJK, propozoi deputeten Muzejene Selmani,
Slobodan Petroviq, në emër të deputetëve të Komunitetit serb, propozoi deputeten Jelena Bontiq, dhe
Mahir Yagcilar, në emër të deputetëve të komuniteteve të tjera, propozoi deputetin Albert Kinolli.

Kryesuesja i hodhi në votim propozimet e cekura më lart. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----117;
Kundër-----0;
Abstenime---0.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi i Kosovës njëzëri zgjedhi Komisioni për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve.

Komisioni për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve kaloi në sallën N-10, që ta shikojë dokumentacionin përkatës zgjedhor për deputetët e Kuvendit.

Kryesuesja dha pauzë derisa sa Komisioni ta shqyrtojë materialin përkatës zgjedhor.

Pas pauzës, në emër të Komisionit për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve, deputeti **Idriz Vehapi**, Kuvendit ia paraqiti raportin. Komisioni i përkohshëm për verifikimin e kuorumit dhe të mandatit, në mbledhjen e mbajtur më 21 shkurt 2011, shqyrtoi dokumentacionin zgjedhor: Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të datës 7 shkurt 2011, për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të mbajtura më 12 dhjetor 2010, Listën e deputetëve të regjistruar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit zgjedhor konstatoi:

Në legjislaturën e katërt të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga subjektet politike, koalicionet, iniciativat qytetare që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e datës 12 dhjetor 2010, si vijon: Partia Demokratike e Kosovës - 34 deputetë, Lidhja Demokratike e Kosovës - 27 deputetë, “Vetëvendosje” - 14 deputetë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - 12 deputetë, Koalicioni AKR, PD, PSD, PPI, PPK, PNDSH dhe PGJK- 8 deputetë, subjekti SLS - 8 deputetë, subjekti KDTP - 3 deputetë, subjekti JSL - 4 deputetë, subjekti Vakrat - 2 deputetë, subjekti PDAK -1 deputet, subjekti NDS - 1 deputet, subjekti PSDAK - 1 deputet, subjekti RDK - 1 deputet, subjekti PAI - 1 deputet, subjekti SDSKIM - 1 deputet, subjekti GIK - 1 deputet dhe subjekti PREBK - 1 deputet.

Komisioni njëherësh konstatoi se në bazë të evidencës së deputetëve prezentë në mbledhjen e sotme konstitutive të legjislaturës së katërt, janë të pranishëm 118 deputetë. Komisioni i rekomandon Kuvendit që të bëjë verifikimin e mandateve të deputetëve dhe t’i vazhdojë punimet sipas agjendës së paraparë dhe rregullave të procedurës.

Kryesuesja e hodhi në votim raportin e Komisioni. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----118;
Kundër-----0;
Abstenime---0.

Kryesuja konstatoi se Kuvendi i Kosovës njëzëri miratoi Raportin e Komisionit për verifikimin e kuorumit dhe të mandateve.

2. Betimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Kryesuesja, në bazë të nenit 10 të Rregullores së Kuvendit, kërkoi nga deputetët që ta japin betimin solemn. Deputetët u ngritën në këmbë, kurse ajo lexoi tekstin e betimit, si vijon: “Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”. Në fund, deputetët shqiptuan fjalën: **“B e t o h e m i”!**

3. Zgjedhja e Kryetarit të Kuvendit

Kryesuesja, në mbështetje të nenin 67.2 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe të nenin 12. 2 të Rregullores së Kuvendit, kërkoi nga grupi më i madh parlamentar, Partia Demokratike e Kosovës, që të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit të Kosovës.

Deputeti Zenun Pajaziti, në emër të Partisë Demokratike e Kosovës, për Kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës propozoi Jakup Krasniqin.

Kryesuesja hodhi në votim propozimin e Partisë Demokratike e Kosovës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----90;
Kundër-----17;
Abstenime---3.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Jakup Krasniqit, Kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Zgjedhja e nënkryetarëve të Kuvendit

Kryesuesja, në mbështetje të nenin 67.3 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe të nenit 12.3 të Rregullores së Kuvendit, kërkoi nga tri grupet më të mëdha parlamentare, që ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Deputeti **Zenun Pajaziti**, në emër të Partisë Demokratike e Kosovës për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës e propozoi deputetin **Xhavit Haliti**.

Deputeti **Ismet Beqiri**, në emër të Lidhjes Demokratike e Kosovës, për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës propozoi deputetin **Sabri Hamiti**.

Deputeti **Visar Ymeri**, në emër të Lëvizjes “VETVENOSJE”, për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës propozoi deputetin **Glauk Konjufca**.

Kryesuesja hodhi në votim propozimet e cekura më lart. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----100;
Kundër-----14;
Abstenime---0.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGHJEDHJEN E NËNKRYETARËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

1. **Xhavit HALITI**, zgjedhet nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Grupi Parlamentar i PDK-së,
2. **Sabri HAMITI**, zgjedhet nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Grupi Parlamentar i LDK-së,

3. **Glauk KONJUFCA**, zgjedhet nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”.

Pastaj, kryesuesja, në mbështetje të nenit 67. 4 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës dhe të nenit 12. 4 të Rregullore së Kuvendit, kërkoi nga deputetët që mbajnë vendet e garantuara për komunitetin Serb dhe deputetët që mbajnë vendet e garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit.

Deputeti **Slobodan Petroviq**, në emër të deputetëve të komunitetit serb, për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës e propozoi deputetin **Petar Miletiq**.

Deputeti **Mahir Yagcilar**, në emër të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë, për nënkryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës e propozoi deputetin **Enis Kervan**.

Kryesuesja hodhi në votim propozimet e cekura më lart. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----68;
Kundër-----15;
Abstenime---14.

Kryesuesja konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

PËR ZGHJEDHJEN E NËNKRYETARËVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA RADHA E KOMUNITETEVE

1. **Petar Miletiq**, zgjedhet nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radha e deputetëve të komunitetit serb,
2. **Enis KERVAN**, zgjedhet nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radha e deputetëve të komuniteteve të tjera.

Në fund, Kryetari i rizgjedhur, Jakup Krasniqi, falënderoi deputetët e Kuvendit për besimin e dhënë. Ai tha se Kuvendi gjatë Legjislaturës IV, në bashkërendim me institucionet e tjera, do ta realizojë rolin e tij kushtetues.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 13:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Njësia për Çështje Plenare dhe Procedurale